

WORCESTER PUBLIC SCHOOLS

Drew Weymouth
Director of Innovation Pathways
weymouthdg@worcesterschools.net
Telephone (508) 799-1985
Fax (508) 799-1933



Worcester Technical High School
1 Skyline Drive
Worcester, Massachusetts 01605
Telephone (508) 799-1940

2021

Të Dashur Prindër dhe Kujdestarë,

Gjatë gjithë janarit, nxënësit e klasave të nënta do të kenë mundësinë të mësojnë rreth Programit të Rrugëve të Inovacionit (Innovation Pathways) në Shkollat Publike Worcester. **Ju lutemi kini mendjen për email dhe telefonata në lidhje me seancat e informacionit për të prezantuar më tej Rrugët e Inovacionit si dhe një Shtëpi Virtuale të Hapur më 11 Shkurt për të ndihmuar nxënësit të vendosin se në cilat programe dëshirojnë të aplikojnë.** Ju lutem gjithashtu vizitoni:

<https://worcesterschools.org/academics/career-pathways/innovation-pathways-program/>.

Programi i Rrugëve të Inovacionit u krijua për të ndihmuar në zgjerimin e eksplorimit të karrierës përmes arsimit teknik brenda Shkollave Publike Worcester. Nxënësit që marrin pjesë në program do të përjetojnë një vështrim të thellë në një fushë karriere të interesit të tyre, do të fitojnë kredenciale të njohura të industrisë në atë fushë, do angazhohen në kolegje dhe aktivitete të planifikimit të karrierës, do marrin klasa të nivelit të kolegjeve në përgatitje për përparimin e karrierës dhe do të pasurojnë përvojën e tyre përmes praktikave ose një projekti përfundimtar përmbledhës. Shkollat Publike Worcester kanë punuar me shumë organizata dhe biznese lokale për të krijuar një program që plotëson nevojat dhe interesat e nxënësve si dhe kërkesat e ardhshme të tregut të punës.

Programi i Rrugëve të Inovacionit është i hapur për nxënësit aktualë të klasave të 9-ta dhe 10-ta (preferenca u jepet nxënësve të klasave të 9-ta) që ndjekin shkollat e Mesme Burncoat, Claremont, Doherty, North, South dhe University Park. **Një link me ftesë për Shtëpinë Virtuale të Hapur të 11 Shkurtit** (si dhe sesione më të vogla informacioni përpara kësaj) **do t'u shkojë të gjithë nxënësve përmes email në fillim të Shkurtit.**

Nxënësit e interesuar për karrierë në një nga sektorët e mëposhtëm duhet të marrin në konsideratë aplikimin për në Programin e Rrugës së Inovacionit:

Prodhim i Avancuar (Advanced Manufacturing) – Modele në Kompjuter, krijim produkti, printim 3-D, përdorim makinerish

Biznes dhe Marketing – Aftësi në biznes dhe financë, sipërmarrje, marketing për të targetuar audiencë

Shkencë Kompjuteri – Programim Kompjuteri dhe Krijim Website

Ndërtim dhe Inxhinjeri që ka Lidhje me Ndërtimin – Dokumentat e ndërtimit, studim dhe vizitë dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave komerciale, dizajn i ndihmuar nga kompjuteri, marangoz dhe aftësi të tjera ndërtimi

Kujdes Shëndetësor – Kujdesi bazik ndaj pacientit, terminologji mjekësore, anatomi dhe fiziologji, hulumtim i një varieteti karrierash në kujdesin shëndetësor, trajnim për tu bërë ndihmës infermieri i çertifikuar.

Teknologji Informacioni – Sistemet operative, pajisjet e kompjuterit, rrjeti, siguria kibernetike

Shkencat e Jetës – Kërkime biologjike, aftësi laboratorike, krijimi dhe prodhimi i ilaçeve/ medikamenteve

Detajet e Programit të Rrugëve të Inovacionit:

- Të gjithë komponentët e këtij programi janë pjesë e krediteve të tyre të rregullta pasi ata punojnë drejt diplomimit dhe do të jenë në transkriptet e tyre

- Dy vjet klasa në sektorin e zgjedhur të karrierës në Shkollën e Mesme Teknike Worcester years
 - 1:30pm-5:15pm dy ditë në javë (zakonisht nga Nëntori- Mars)
 - Nxënësit mbarojnë dhe transportohen me autobus në orën 1:00pm nga shkolla e tyre në Worcester Tech për të marrë pjesë në ditët e klasës
 - Klasat mbahen të Martë, të Mërkurë dhe të Enjte por zakonisht mbahen vetëm në dy nga këto ditë
- Regjistrimi në klasat e Planifikimit Akademik dhe të Karrierës në shkollën e tyre të mesme
 - Studim për kolegje dhe karriera të ardhshme, mësimi dhe praktikim i aftësive të punësimit, përmirësimi i aftësive teknike dhe të komunikimit dhe garantim i suksesit të tyre në shkollë dhe në Programin e Rrugëve të Inovacionit
- Një praktikë 100-orëshe (zakonisht në verë) ose një projekt përmbledhës në maturë
- Përfundimi i dy klasave të nivelit kolegji gjatë shkollës së mesme

Aplikimet do të jenë të disponueshme duke filluar nga 22 Shkurt 2021 (pas pushimeve të Shkurtit) si në internet ashtu edhe përmes kujdestarëve. Kandidatët e mirë po kalojnë klasat e tyre në këtë pikë të vitit, kanë frekuentim dhe përkushtim të mirë në shkollë (madje edhe gjatë mësimit në distancë), përfundojnë detyrat në kohë dhe nuk kanë asnjë shqetësim lidhur me sigurinë gjatë shkollës së mesme.

Ju lutemi konsideroni nëse nxënësi juaj ka kohë dhe interes për të përfunduar këtë program. Nëse nxënësit aplikojnë dhe pranohen, angazhimi ndaj këtij programi zëvendëson të gjitha angazhimet e tjera gjatë orëve të planifikuara. Ky është një shans shumë i mirë për të bashkuar planifikimin akademik dhe atë të karrierës për nxënësin tuaj. Ju faleminderit për konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Drew Weymouth
 Drejtor i Rrugëve të Inovacionit
 Shkollat Publike Worcester
 Telefoni: (508)799-1985
 Email: weymouthdg@worcesterschools.net